



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602237/5

Tiranë ___/___/2017

Lënda : Rekomandim për trajtimin ligjor të hyrjes në fuqi të akteve administrative, për miratimin e projekteve "Rikonstruksioni i rrugës Unaza "1 Maj"" dhe "Rikualifikimi urban në Bashkinë Himarë".

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë Himarë
Z. Jorgo GORO

HIMARË

Për dijani: Kryetarit të Këshillit Bashkiak, Himarë
Z. Foto KARAVELLA

HIMARË

I nderuar z. Goro!

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, një grup shtetasish banorë të qytetit të Himarës kanë paraqitur disa ankesa të ndryshme individuale, në të cilat ngrihen shqetësime që lidhen me procesin e konsultimit dhe miratimit të dy projekteve, që do të zbatohen në territorin e Bashkisë, Himarë, si dhe cënimit të mundshëm që mund t'i shkaktojnë aktet përfundimtare administrative të nxjerrë nga ana e autoriteteve përgjegjëse të Bashkisë Himarë, të drejtave dhe interesave të ligjshëm të këtyre individëve, si dhe të komunitetit të banorëve të qytetit të Himarës në tërësi.

Më konkretisht bëhet fjalë për, projektet "Rikonstruksioni i rrugës Unaza "1 Maj"" dhe "Rikualifikimi urban në bashkinë Himarë".

Me marrjen në shqyrtim të këtyre ankesave i jemi drejtuar një sërë institucioneve përgjegjëse shtetërore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Bashkinë Himarë, për marrjen e informacionit dhe shpjegimeve lidhur me procedurat e ndjekura në këtë rast dhe konfirmimin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve administrative, të cilat përbëjnë miratimin përfundimtar të planeve të detajuara vendore përkatëse.

Në këto kushte, duke pasur parasysh edhe vendndodhjen teritoriale në zonën e bregdetit të jugut të Bashkisë, Himarë, kemi kërkuar shpjegime nga ana Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, lidhur me çështjet nëse;

- 1- Ky projekt, në kuptim të ligjit nr.107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, të ndryshuar, përbën një dokument planifikimi për të cilin kërkohet edhe shqyrtimi dhe vendimarrja përkatëse nga ana e këtyre organeve?
- 2- Nëse po, a është paraqitur ky projekt i Bashkisë Himarë, pranë tyre për shqyrtim dhe miratim dhe në cilën fazë ndodhet ky proces?

Shpjegime, informacion dhe kopje dokumentesh zyrtare janë kërkuar në mënyrë të përsëritur edhe nga ana e institucionit të Bashkisë, Himarë, në mënyrë të përgjithshme por edhe në referencë të ankesave individuale që kemi në shqyrtim, sa i takon:

- Akteve administrative respektive me të cilat janë miratuar përfundimisht projektet: “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Majj”” dhe “Rikualifikimi urban në Bashkinë, Himarë”.
- Botimit nga Bashkia, Himarë në Regjistrin e Integruar të Territorit, të Administruar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, të ndonjë akti apo dokumentacioni që lidhet me dy projektet e sipërcituara.
- Dokumentacionit zyrtar provues që vërteton kryerjen e një procesi efektiv konsultimi dhe diskutimi me komunitetin e banorëve të Bashkisë, Himarë, gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të të dy projekteve të sipërcituara.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e Agjencisë Kombëtare të Territorit (AKPT), me shkresën nr.1712/1 datë 25.11.2016 ndër të tjera sqarohet se, projektet që janë objekt shqyrtimi në ankesat e paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit, nuk përbëjnë dokument planifikimi, sipas përcaktimeve të dhëna në ligjin nr.107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar.

Në vazhdim sqarohet se, në kohën që kryente funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), AKPT-ja nuk ka shqyrtuar dhe përcjellë për miratim në KKT asnjërin prej projekteve “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Majj””, dhe “Rikualifikimi urban në bashkinë Himarë”. Në zbatim të Vendimit nr.1 datë 22.08.2014 të KKT, “*Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrative-territoriale*” (i shfuqizuar), sipas përgjigjes AKPT-ja nuk ka shqyrtuar asnjë aplikim për këto projekte.

Po kështu, po në këtë përgjigje sqarohet se, nga kontrolli në Regjistrin e Integruar të Territorit, administruar nga AKPT rezulton se Bashkia, Himarë, nuk ka botuar asnjë akt/dokumentacion, lidhur me projektet në fjalë.

Në përfundim të përgjigjes thuhet se, gjatë kërkimit që kjo Agjenci ka kryer për dhënien e informacionit në këtë rast ka rezultuar se, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr.630 datë 7.09.2016 “*Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maji”, Himarë*”.

Në përgjigje e dhënë nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, me shkresën nr.2092/1 datë 28.11.2016, sqarohet se, sa i takon projektit “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maji”, Himarë”, meqë Bashkia, Himarë, është një prej autoriteteve vendore të përmendura nenin 45, të VKM nr.408 datë 13.05.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, në të cilin evidentohen Bashkitë që kanë plane të përgjithshme vendore, të miratuara, atëherë kërkesat për leje

zhvillimi/ndërtimi të propozuara në zona brenda territorit të tyre, merren në shqyrtim nga vetë bashkitë. Në këto kushte konfirmohet se, informacioni përkatës mund të gjendet pranë Bashkisë, Himarë, pasi Agjencia e Zhvillimit të Territorit nuk ka marrë në shqyrtim asnjë propozim mbi këtë projekt.

Nga shpjegimet e dhëna nga ana e Bashkisë, Himarë, me shkresën nr.5273 datë 8.11.2016, ndër të tjera citohet shprehimisht se:

“... në kuadër të zbatimit të projektit “Rikualifikim urban në Bashkinë Himarë”, ju vëmë në dijeni se me urdhër të Kryetarit të Bashkisë është ngritur një grup për fillimin e praktikave të procedurës së shpronësimit për objektet që do të prishen si pasojë e ndërhyrjeve rehabilituese të zonës.

Materiali grafik dhe numerik i mbledhur nga ky grup do të përpunohet dhe më pas do t'i përcillet një komisioni të posaçëm, i cili ngrihet për çdo projekt në Ministrinë e Zhvillimit Urban, ku më pas do të finalizohet procedura e shpronësimit me anë të një vendimi të kryetarit të këtij komisioni...

Aktualisht grupi i ngritur me urdhërin e Kryetarit është duke korresponduar informacionet me ZVRPP, Vlorë, në koordinim me qytetarët që preken nga ky projekt, të cilët herë pas here sjellin informacione mbi pronësitë e tyre pranë Bashkisë.

Ky proces do të vazhdojë deri në konstatimin e plotë të pronave që do të shpronësohen duke parashikuar këtu edhe vështirësinë që ka ky proces si pasojë se zona e Himarës është zonë e pamenaxhuar përsa i përket pronave”.

Veç kësaj nga inspektimi i kryer nga një grup ekspertësh të institucionit të Avokatit të Popullit, në datë 20.12.2016 në Bashkinë Himarë, ka rezultuar se, në funksion të miratimit të projektit “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maj””, ju në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, Himarë, keni nxjerrë Leje Zhvillimore Infrastruktura me nr.prot. 438 datë 20.03.2015, ndërsa për projektin “Rikualifikimi urban në Bashkinë, Himarë”, ju keni nxjerrë Vendimin nr.2898/1 datë 23.09.2016 “Për miratimin e projektit “Rikualifikim urban Spile, Himarë”.

Nga një analizë konkrete të bazës ligjore që rregullon procedurën e nxjerrjes së akteve që trajtohen në këtë rekomandim, referuar ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, evidentojmë që:

Në pikën 10, në pikën 17 dhe në pikën 45, të nenit 3, të ligjit, përcaktohet shprehimisht se:

“E drejta për zhvillim është e drejta ligjore për të zhvilluar një parcelë dhe/ose një zone në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit. E drejta për zhvillim është e dallueshme nga e drejta e pronësisë dhe jepet nga autoriteti vendor i planifikimit, që ka kompetencën për të rregulluar përdorimin e tokës në juridiksionin e tij, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Të drejtat për zhvillim mund të mbahen nga pronari i tokës, të shkëmbehen ose të shiten”.

“Leje zhvillimi” është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/prone të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi”,

“”Zhvillim” është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja ose ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese”.

- Sipas gërmës “ç”, të nenit 4 dhe gërmave “a” dhe “b” të pikës 1.3, të nenit 5 të ligjit, thuhet se:
*“Zhvillimi duhet të udhëhiqet nga planifikimi, i cili është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet e planifikimit sipas këtij ligji”,
 Autoriteti përgjegjës për planifikimin e territorit janë:*
 - a) *Këshilli bashkiak*
 - b) *Kryetari i bashkisë”.*

Sipas gërmave “a”, “d” dhe “dh”, të nenit 9, si dhe pikat 2 dhe 3, të nenit 23 të ligjit, thuhet respektivisht se:

“Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji është përgjegjëse:

- *Për të bashkërenduar, në përgjithësi, procese të hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të cilat ndërmerren nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror dhe vendor,*
- *Organizimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së integruar të të dhënave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit - Regjistri i Integruar i Territorit – me të gjitha dokumentet e planifikimit të nivelit qendror dhe vendor, të cilat kanë hyrë në proces miratimi apo janë miratuar nga autoritetet përkatëse, si dhe të dhëna të tjera shtesë, të cilat ndërlidhen me planifikimin dhe zhvillimin e territorit,*
- *Për kontrollin e përputhshmërisë së akteve të botuara në regjistër me ligjet, dokumentet e planifikimit dhe ato të kontrollit të zhvillimit në fuqi”.*
- *“Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit këshillohet rregullisht me AKPT-në dhe palët e interesuara dhe i informon ato çdo muaj mbi ecurinë e procesit,*
- *AKPT-ja shqyrton përputhshmërinë e projektaktit të dokumentit të planifikimit me dispozitat ligjore e nënligjore të zbatueshme në fushën e planifikimit të territorit, si dhe me dokumentet e planifikimit në fuqi. Në përfundim të shqyrtimit, AKPT-ja i përcjell autoritetit përgjegjës përfundimet dhe propozimet përkatëse për trajtimin e mangësive”.*

Lidhur me përgjegjësitë e këshillit bashkiak, si autoritet përgjegjës për planifikimin e territorit, në gërmat “ç” dhe “d” të pikës 2, të nenit 12, të ligjit thuhet se:

- *“Këshilli bashkiak është përgjegjës për të:*
 - *Monitoruar respektimin e kuadrit ligjor për pjesëmarrjen dhe shqyrtimin publik të dokumenteve vendor të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, gjatë procesit të hartimit të tyre,*
 - *Rikthyer për shqyrtim, tek kryetari i bashkisë, planet e detajuara vendore, në rast se konstaton mosrespektim të kërkesave ligjore”.*

Ndërsa lidhur me përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë si autoritet përgjegjës për planifikimin e territorit, veçojmë gërmat “a”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të nenit 13 të ligjit, ku thuhet se:

“Kryetari i bashkisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për:

- *Zhvillimin e territorit vendor, përmes hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit të territorit,*
- *Dorëzimin dhe prezantimin e dokumenteve vendore të planifikimit pranë AKPT-së, për të verifikuar përputhshmërinë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe normat teknike të planifikimit,*
- *Miratimin e planeve të detajuara të vendore”.*

Në kuptim të përcaktimeve të dhëna në nenin 15, të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në dokumentet e planifikimit në nivel vendor, përfshihen edhe “Planet e detajuara vendore”, (pika 1.2.3, e pikës 1.2, të nenit 15).

Në zhvillim të konceptit ligjor për këtë dokument planifikimi vendor, në nenin 22 të ligjit, përcaktohet se këto plane hartohen me nismë publike, ose private, dhe se planet e detajuara vendore kanë për objekt nëndarjen dhe/ose bashkimin për qëllim zhvillimi.

Sipas përcaktimeve të dhëna në këtë nen, veçojmë përcaktimet e bëra në pikat 5, 6, 7, dhe 9, ku thuhet se:

“Nisma duhet të mbështetet nga pronarët që kanë në pronësi jo më pak se 51% të sipërfaqes së zonës, për të cilën propozohet plani i detajuar vendor,

Kryetari i bashkisë merr vendimin mbi miratimin e planit të detajuar vendor brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar dhe pasi ka informuar dhe kryer takime publike me palët e interesuara,

Kryetari i bashkisë vendos mbi miratimin e planit të detajuar vendor mbi bazën e raportit teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoriteti vendor dhe të botuar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse,

Në përfundim të procesit, kryetari vendos në lidhje me miratimin e planit duke u shprehur edhe në lidhje me pranimin ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të depozituara”.

- Sikurse përcaktohet në nenin 56 të ligjit, botimi në regjistër i të gjitha projektakteve, ose akteve të miratuara që lidhen me planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, përfshirë dokumentacionin shoqërues dhe vërejtjet apo propozimet gjatë bashkërendimit të planifikimit, janë të detyrueshme për botim, veç rasteve përjashtimore të përcaktuara në ligj. Për më tepër, botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit, ndërkohë që projektaktet dhe aktet që janë të detyrueshme për botim në regjistër botohen në regjistër brenda 10 ditëve nga data e vendimit përkatës.

I nderuar z. Goro!

Duke patur në referencë edhe përcaktime më të detajuara të dhëna në VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, si dhe në mënyrën dhe procedurat konkrete që janë ndjekur nga ana e titullarit të Bashkisë, Himarë, në cilësinë e autoritet përgjegjës për planifikimin e territorit, për hartimin dhe miratimin e projekteve

Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maj” dhe “Rikualifikimi urban në bashkinë Himarë”, konstatohet se:

1. Në cilësinë e autoritetit përgjegjës për planifikimin e territorit, në nivel vendor, ju si kryetar i Bashkisë Himarë, për miratimin e projektit “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maj”, keni nxjerrë aktin administrativ, Leje Zhvillimore Infrastruktura me nr.prot. 438 datë 20.03.2015. Ndërkohë, për miratimin e projektit “Rikualifikimi urban në Bashkinë, Himarë”, ju keni nxjerrë aktin administrativ, vendimi nr.2898/1 datë 23.09.2016 “Për miratimin e projektit “Rikualifikim urban Spile, Himarë”. Në kuptim të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të dy projektet e miratuara janë plane të detajuara vendore për qëllim zhvillimi. Sikurse edhe ligji e kërkon, në aspektin formal, zhvillimi është paraprirë nga planifikimi.
2. Nuk rezulton të jetë kryer procesi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit horizontal dhe vertikal, të autoritetit të autoritetit përgjegjës për planifikimin e territorit, në nivel vendor, me AKPT-në. Kjo gjë del qartë nga përgjigja e Agjencisë Kombëtare të Territorit (AKPT), dhënë me shkresën nr.1712/1 datë 25.11.2016. Rrjedhimisht nuk kemi një akt nga ana e AKPT-së, ku të shprehet përputhshmëria e projektaktit të dokumentit të planifikimit me dispozitat ligjore e nënligjore të zbatueshme në fushën e planifikimit të territorit, përkatësisht për të dy projektet, “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maj” dhe “Rikualifikim urban Spile, Himarë”. Si një kërkesë ligjore procedurale ky dokument do të ishte i rëndësishëm edhe për pasqyrimin dhe përcjelljen nga ana e AKPT-së të përfundimeve dhe propozimeve përkatëse për trajtimin e mangësive të mundshme.
3. Nuk rezulton të jetë kryer botimi në Regjistrin e Integruar të Territorit, fillimisht të projektakteve, apo më pas edhe të akteve të miratuara, që lidhen me hartimin dhe miratimin e projekteve, “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maj” dhe “Rikualifikim urban Spile, Himarë”. Po kështu, nuk janë botuar në këtë regjistër as dokumentacioni shoqërues dhe as vërejtjet, apo propozimet, gjatë bashkërendimit të planifikimit, të cilat janë të detyrueshme për botim, pasi legjislativi në fuqi nuk parashikon ndryshe për këtë rast. Botimi në regjistër, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të akteve administrative, Leje Zhvillimore Infrastruktura me nr.prot. 438 datë 20.03.2015, dhe vendimit nr.2898/1 datë 23.09.2016 “Për miratimin e projektit “Rikualifikim urban Spile, Himarë”.
4. Në kushtet kur nga ana e vetë Bashkisë, Himarë, citohet dhe pranohet fakti se, zona e Himarës është zonë e pamënaxhuar përsa i përket pronave, mbetet një mangësi me vehte plotësimi i kushtit procedural ligjor për mbështetjen që duhet të marrë nisma për zhvillim, nga pronarët që kanë në pronësi jo më pak se 51% të sipërfaqes së zonës, për të cilën propozohet plani i detajuar vendor. A janë evidentuar këta pronarë të mundshëm dhe cila është kompetenca e Bashkisë Himarë në këtë proces, kur ligji njeh autoritetin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme për konstatimin paraprak të pronësive individuale private, apo shtetërore, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri ligjor? Kjo mangësi e paraqitur në këto rrethana bëhet edhe më e evidente kur ligji përcakton se: ”Kryetari i bashkisë vendos mbi miratimin e planit të detajuar vendor mbi bazën e raportit teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoriteti vendor dhe të botuar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse”.

5. Në aktet administrative të nxjerra nga ana juaj, përkatësisht, Leje Zhvillimore Infrastrukturore, me nr.prot. 438 datë 20.03.2015, dhe vendimi nr.2898/1 datë 23.09.2016 *“Për miratimin e projektit “Rikualifikim urban Spile, Himarë”, nuk është pasqyruar dhe shprehur vullneti i organit të administratës publike (Kryetarit të Bashkisë, Himarë), ndër të tjera në lidhje me, pranimin, ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të depozituara. Theksojme se kjo është pjesë e arsytimit të aktit dhe një kërkesë e parashikuar shprehimisht nga ligji.*
6. Nga dokumentet e marra si informacion nga ana e Bashkisë Himarë kemi konstatuar vetëm një proces verbal të mbajtur në datën 16.06.2016, në një takim prezantues të projektit *“Rikualifikim urban në Bashkinë Himarë”, me banorët e Himarës. Përpos kundërshtive të shumta që janë përshkruar në këtë proces-verbal, nga ana e pjesmarrësve në këtë takim me cilësinë e banorëve të qytetit Himarë, nuk gjejmë mjaftueshëm praktikë që të ezaurojë kërkesën ligjore të këshillimit të rregullt me AKPT-në dhe palët e interesuara dhe të informimit të tyre të përmuajshëm mbi ecurinë e procesit.*
7. Roli i Këshillit Bashkiak, Himarë, në gjithë këtë proces na rezulton inekzistent, pavarësisht kompetencave ligjore që atij i jepen nga ligji.
8. Sikurse na ka rezultuar nga disa ankesa individuale Bashkia Himarë në funksion të zbatimit të projektit *“Rikualifikim urban në Bashkinë Himarë”, ka dërguar njoftime individuale tek banorë të caktuar pronat e të cilëve preken sipas njoftimit nga ky projekt, për prishje objekti në përputhje me parashikimet e ligjit “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar. Po kështu, është vazhduar paralelisht në rastin e projektit “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maj”, me procedurat e shpronësimit dhe përcjelljen e të gjithë dokumentacionit përkatës për këtë qëllim, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, procedure kjo e finalizuar aktualisht me VKM nr.630 datë 7.09.2016 *“Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajhtëshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maji”, Himarë”.**

Konkluzioni më i rëndësishëm që nxirret në këtë fazë të trajtimit të kësaj çështjeje është që, në kuptim të përcaktimeve ligjore në fuqi, aktet administrative, përkatësisht, Leje Zhvillimore Infrastrukturore me nr.prot. 438 datë 20.03.2015, dhe vendimit nr.2898/1 datë 23.09.2016 “Për miratimin e projektit “Rikualifikim urban Spile, Himarë”, nuk kanë hyrë ende në fuqi. Si të tilla ato nuk mund të krijojnë efekte juridike për subjektet të cilave iu drejtohen, pra as nuk lindin, shuajnë apo ndryshojnë pasoja juridike të caktuara.

Është e rëndësishme të theksohet se krahas kërkesave për përmbajtjen ligjore që duhet të ketë akti administrativ, rëndësi paraqesin edhe çështjet që lidhen me fuqinë juridike të aktit, sikurse edhe në këtë rast.

Për më tepër, për disa elementë që lidhen kryesisht me procedurën e nxjerrjes së Lejes Zhvillimore Infrastrukturore me nr.prot. 438 datë 20.03.2015, dhe vendimit nr.2898/1 datë 23.09.2016 *“Për miratimin e projektit “Rikualifikim urban Spile, Himarë”, vihet në diskutim edhe pjesa e ligjshmërisë së këtyre akteve administrative, gjë që rëndon pozitën e sjelljes së pasojave juridike jo vetëm të një akti që ende nuk ka hyrë në fuqi, por që edhe mund të rezultojë i paligjshëm.*

Rrjedhimisht, çdo akt tjetër administrativ i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tyre nuk mund të jetë i ligjshëm dhe as të ketë fuqi juridike, për të prodhuar pasoja të tjera në vazhdim.

Sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 164, të Ligjit nr.44/2015, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, akti administrativ mund të ekzekutohet (zbatohet) vetëm pasi ka hyrë në fuqi.

Kjo mënyrë trajtimi rezulton se shkel edhe një nga të drejtat themelore të shtetasve që ka të bëjë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në rrafshin administrative të trajtimit të çështjes.

Në këtë këndvështrim, duam t'ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administrates publike, sipas të cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.

Nga ana tjetër, në akordancë me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21/b, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar dhe ku thuhet përkatësisht, shprehimisht se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit... ..,

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

“Pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit kryen këto veprime:

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË

1.Ndjekjen rigoroze të procedurës ligjore dhe korigjimin e mangësive apo shkeljeve ligjore, për miratimin e projekteve “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maj” dhe “Rikualifikimi urban në bashkinë Himarë”, aktualisht ende në kuptim të ligjit në proces miratimi.

2.Pezullimin e çdo veprimi të mëtejshëm që lidhet me zbatimin e akteve administrative, përkatësisht Leje Zhvillimore Infrastruktura me nr.prot. 438 datë 20.03.2015, dhe vendimit nr.2898/1 datë 23.09.2016 “Për miratimin e projektit “Rikualifikim urban Spile, Himarë”, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë së akteve të nxjerra në zbatim të tyre.

3. Kryerjen e një konsultimi sa më të gjerë dhe sa më transparent publik për konkretizimin e një vendimmarrjeje të gjithëpranuar me komunitetin e banorëve të qytetit të Himarës, pa përjashtuar rëndësinë e bashkërendimit procedural ligjor me AKPT-në.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj, ndaj këtij rekomandimi.
Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka